

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6139
E enjte, 15 tetor 2020
çmimi 0.40 €

Fillon dhënia e patentëshoferëve ndërkombëtarë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I VENDIT, HASHIM THAÇI, PAS KTHIMIT NGA VIZITA NË SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA), KA MBAJTUR KONFERENCË PËR MEDIA

THAÇI: NJOHJA RECIPROKE TË JETË PIKA E PARË E MARRËVESHJES KOSOVË-SERBI



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar që njohja reciproke të jetë pika e parë e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi. Në një konferencë për media, ai ka thënë

se tani ka ardhur koha që kjo çështje të ngrehet në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Shefi i shtetit ka vlerësuar se ShBA-ja dhe BE-ja kanë koordinim për

këtë proces. Ai ka vlerësuar se ky koordinim duhet të reflektojë edhe brenda në Kosovë që të ketë një unitet përballë dialogut me Serbinë

RRITET NUMRI I RASTEVE ME COVID-19, HOTI PARALAJMËRON MASA EKSTREME



Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë ka vdekur një person nga Covid-19 si dhe janë paraqitur 80 raste të reja, duke shënuar një rritje të lehtë të infektiveve me këtë virus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar edhe 55 persona, duke e çuar në 14 460 numrin e përgjithshëm të të shëruarave nga Covid. Ky institut ka bërë me dije se në Kosovë janë edhe 1 315 raste aktive me Covid-19

LAJÇAKU TAKOI LIDERËT POLITIKË, TEMË DISKUTIMI DIALOGU KOSOVË - SERBI



OPINION

KRYEQYTETI I QENVE! F. 11

Nga KMDLNj



AKTUALE

BANKA BOTËRORE MIRATON 12 MILIARDË DOLLARË PËR FINANCIM TË VAKSINAVE PËR KORONAVIRUS F. 2



200 USHTARË TË KFOR-it REALIZOJNË NJË USHTRIM PËR SITUATAT EMERGJENTE F. 3

QEVERIA PREMTON MBËSHTETJE TË PLOTË NË AGJENDËN PËR BARAZI GJINORE F. 3

EKONOMI



OEAK-u: PANDEMIA KRIJOI PASIGURI EKONOMIKE TË BIZNESET NË PRONËSI TË GRAVE F. 8

ATK-ja VLERËSOHET LART NË RAPORTIN E BE-së PËR KOSOVËN 2020 F. 8

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Turqia e gatshme ta përkrahë Kosovën për anëtarësim në institucionet dhe mekanizmat e sigurisë

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka zhvilluar sot një bisedë telefonike me ministrin e Punëve të Brendshme të Republikës së Turqisë, Suleyman Soylu. Ministri Veliu falënderoi homologun e vet turk për përkrahjen që Republika e Turqisë i ka ofruar Republikës së Kosovës, në veçanti Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së

Kosovës për ngritjen e kapaciteteve të tyre. Me theks të veçantë u diskutua për menaxhimin e situatës me pandeminë Covid-19 për të dyja vendet dhe masat e ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e saj. Gjatë bisedës, ministrat diskutuan edhe për bashkëpunimin ndërshtetëror mes dy vendeve sa i përket fushës së sigurisë dhe sigurimit të mbështetjes së Turqisë për

avancimin e mekanizmave të sigurisë. Po ashtu, u diskutua edhe për lëvizjet migratore që po përdorin territorin e Republikës së Turqisë dhe përmes korridoreve të tjera po arrijnë në Kosovë. Ministri i Punëve të Brendshme i Republikës së Turqisë, Suleyman Soylu, theksoi kontributin dhe punën e ministrit Veliu dhe të Qeverisë së Kosovës si kontribuues i stabilitetit të qëndrueshëm në rajon.



Vuçiçi: Presim që Prishtina t'i përmbushë detyrimet



PRISHTINË, 14 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka thënë se Beogradi dhe Prishtina do të diskutojnë për një zgjidhje kompromisi për Kosovën, por ka shtuar se pala e Kosovës "duhet të zbatojë atë që ka nënshkruar në Bruksel". "Do të presim, do të tregojmë durim, për të parë se kur do t'i përmbushë detyrimet e saj me marrëveshjen e vitit 2013", ka thënë Vuçiç për Radio Televizionin e Serbisë.

I pyetur nëse formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe është një vijë e kuqe për Beogradin, Vuçiç tha se "nuk reagon më ndaj tregimeve nga Prishtina për njohjen reciproke". Me marrëveshjen e vitit 2013, të nënshkruar midis Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, është paraparë formimi i asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë. Në vitin 2015, dy vendet, nën

ndërmjetësimin e BE-së, kanë arritur edhe një marrëveshje shtesë për themelimin e tij. Por, Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se parimet për të nuk janë në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, edhe pse ka thënë se ato mund të harmonizohen me një akt ligjor të Qeverisë së Kosovës. Prishtina tani thotë se nuk dëshiron ta hapë më këtë çështje, ndërsa Beogradi insiston në të kundërtën.

Banka Botërore miraton 12 miliardë dollarë për financim të vaksinave për koronavirus

NJU-JORK, 14 TETOR - Banka Botërore ka miratuar 12 miliardë dollarë për t'iu ndihmuar shteteve në zhvillim që të blejnë dhe shpërndajnë vaksina për koronavirus, teste dhe trajtime të tjera, me qëllim të mbështetjes së vaksinimit të rreth 1 miliard njerëzve. "Zarfi" prej 12 miliardë dollarëve është pjesë e një pakete më të madhe të Grupit të Bankës Botërore prej rreth 160 miliardë dollarëve, për t'iu ndihmuar shteteve në zhvillim që ta luftojnë pandeminë me koronavirus, ka thënë kjo bankë përmes një deklarate. Banka Botërore ka thënë se programet e saj urgjente për këtë pandemi janë shtrirë në 111 shtete. Qytetarët në shtetet në zhvillim po ashtu duhet të kenë qasje në vaksinën efektive kundër koronavirusit, është thënë në deklaratë. "Ne jemi

duke zgjeruar dhe zmadhuar qasjen e përgjigjes së shpejtë ndaj emergjencës së Covid-19, në mënyrë që shtetet në zhvillim të kenë qasje të drejtë dhe të barabartë në vaksina", ka thënë presidenti i kësaj Banke, David Malpass. Ai ka shtuar se qasja në vaksina efektive dhe forcimi i sistemeve të ofrimit të shërbimeve janë çelës për ndryshim të kursit të pandemisë dhe për t'iu ndihmuar shteteve që po përballen me katastrofa ekonomike dhe ndikim fiskal, në mënyrë që të ecin tutje drejt rimëkëmbjes. Zhvillimi i vaksinës po konsiderohet kyç për ndalje të përhapjes së koronavirusit, i cili ka lënë të vdekur më shumë se 1 milion njerëz dhe ka sëmure 38 milionë të tjerë, ndërkohë që ekonomitë e shkatërruara po përballen me miliona të papunë.



Erdogani: Greqisë do t'i japim përgjigjen që meriton

ANKARA, 14 TETOR - Presidenti turk Rexhep Taip Erdogan ka paralajmëruar dhe kërcënuar Greqinë se do t'i japë përgjigjen që meriton sa i përket sit-

uatës në Mesdheun Lindor gjatë konferencës së mbajtur të mërkurën. "Ne do të dimë t'i japim përgjigjen që meritojnë Greqia dhe Qiproja

greke. U kemi treguar të gjithëve që s'do të ketë plan që nuk respekton të drejtat e vendit tonë dhe Qipros turke në Mesdheun Lindor", ka

thënë presidenti turk. Anija turke Oruç Reis u rikthye për fushatën e saj të hidrokarbureve në Mesdheun Lindor.



Fillon dhënia e patentëshoferëve ndërkombëtarë

Agjencia për Regjistrim Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme, të mërkurën edhe zyrtarisht ka filluar t'i japë patentëshoferët ndërkombëtarë. Prej njoftimit për fillimin e prodhimit të patentëshoferëve ndërkombëtarë deri më tani rreth 500 qytetarë kanë aplikuar për t'u pajisur me këtë dokument



përmirësimit të shërbimeve për qytetarët e Kosovës dhe ndarja e patentëshoferit ndërkombëtar është në trendet e ARC-së dhe të MPB-së për përmirësimin e shërbimeve për qytetarët e Kosovës. Ai ka thënë se prej

njoftimit për fillimin e prodhimit të patentëshoferëve ndërkombëtarë deri më tani rreth 500 qytetarë kanë aplikuar për t'u pajisur me këtë dokument. Në fund Hoxha ka thënë se në kuadër të lehtësimit

të shërbimeve për qytetarët e Kosovës, nga java e ardhshme do të fillojnë shërbimet për vulat apostile edhe në disa qytete të tjera të Kosovës dhe nuk do të jetë e koncentruar vetëm në Prishtinë.

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 14 TETOR - Agjencia për Regjistrim Civil e Ministrisë së Punëve të Brendshme të mërkurën edhe zyrtarisht ka filluar t'i japë patentëshoferët ndërkombëtarë. Në ceremoninë e shpërndarjes morën pjesë Bajram Gecaj, shef i kabinetit të ministrit të Punëve të Brendshme dhe drejtori i përgjithshëm i Agjencisë për Regjistrim Civil (ARC), Bekim Hoxha. Me këtë rast, shefi i kabinetit të ministrit të MPB-së, Bajram Gecaj, ka theksuar se me aktin e sotëm të shpërndarjes së patentëshoferëve ndërkombëtarë, po tregojmë përkushtimin dhe avancimin e ARC-së dhe MPB-së për përmirësimin e shërbimeve për qytetarëve të Kosovës.

Ai ka thënë se ky patentëshofer do t'u hyjë në punë qytetarëve në disa shtete, deri në njohjen ndërkombëtare të patentëshoferëve sipas konventës ndërkombëtare, për të cilin, për ta realizuar, Republika e Kosovës duhet të jetë pjesë e OKB-së. "Ne jemi duke bërë përpjekje individuale me shtet, ku e kemi të koncentruar komunitetin tonë, si me Italinë, Gjermaninë dhe Austrinë, për të arritur marrëveshje individuale me këto shtete për njohje të patentëshoferëve të Republikës së Kosovës, në mënyrë që t'i mundësojmë diasporës sonë që të ketë qasje më të lehtë në këto shtete me dokumente të Kosovës", ka thënë Gecaj.

Ndërsa drejtori i përgjithshëm i ARC-së, Bekim Hoxha, vuri në dukje se me aktin e sotëm po tregohet një vazhdimësi e

Qeveria premtion mbështetje të plotë në agjendën për barazi gjinore

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, mori pjesë në takim të nivelit të lartë konsultativ, me temë "Fuqizimi ekonomik si parakusht i parandalimit të dhunës në familje dhe dhunës në baza gjinore", të organizuar nga Agjencia për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit në bashkëpunim me Qendrën Kosovare për Studime Gjinore.

Në fjalën e tij para panelistëve dhe të pranishmëve, kryeministri Hoti tha se gjendet sot para tyre për t'i garantuar të gjithë se gjatë qeverisjes së tij do të mundohen maksimalisht që të japin mbështetje të plotë në agjendën për barazi gjinore. "Brenda zyrës tonë, brenda zyrës së kryeministrit promovohet dhe mbështetet fuqishëm kauza për barazi gjinore dhe jemi duke dhënë mbështetjen e nevojshme që përmes rrjetit të OJQ-ve, përmes rrjetit të institucioneve, ta promovojmë këtë agjendë", ka thënë Hoti.

Më tej, kryeministri Hoti ka theksuar se në kuadër të Pakos për Rimëkëmbje Ekonomike, përveç mbështetjes që marrin të gjitha bizneset, pavarësisht a janë me pronarë gra apo burra,



të kemi edhe një pako të veçantë për mbështetjen e grave në biznes dhe në shoqëri në përgjithësi, duke u fokusuar tek ato gra që janë ndikuar nga pandemia. "Po ashtu, në qeveritë e kaluara, por do ta vazhdojmë edhe tash, përgatitjen e buxhetit vjetor të shtetit që merr për bazë edhe aspektin gjinor nëpër ministri të ndryshme, kur të

dizajnohen projektet dhe kur të planifikohen shpenzimet e ndryshme, do ta marrim parasysh ndikimin e atyre shpenzimeve, atyre projekteve për promovimin e barazisë gjinore", ka thënë Hoti.

Kryeministri Hoti ka pohuar se kjo nuk duhet të jetë vetëm agjendë e tryezave që organizohen mirë dhe fjalimeve

të mira e prezantimeve nëpër media, por punë praktike e përditshme që duhet ta bëjmë, pasi që burrat dhe gratë në shoqëri janë komplementarë, nuk bëjnë njëri pa tjetrin. "Në shoqëritë që ka më shumë barazi gjinore rritja ekonomike është më e madhe, sepse në vendin e punës përgjithësisht në ekonomi, burrat dhe gratë

plotësojnë më së miri njëri-tjetrin", ka deklaruar kryeministri Hoti.

Ndërsa panelistët, duke e vlerësuar angazhimin e kryeministrit Hoti, potencuan edhe mbështetjen e radhës, përkatësisht për ndarjen e fondit për barazi gjinore, si dhe uruan që një bashkëpunim i tillë të thellohet edhe më tej.



Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka mbajtur konferencë për media pas kthimit nga vizita në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA)

THAÇI: NJOHJA RECIPROKE TË JETË PIKA E PARË E MARRËVESHJES KOSOVË - SERBI

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar që njohja reciproke të jetë pika e parë e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi. Në një konferencë për media, ai ka thënë se tani ka ardhur koha që kjo çështje të ngrehet në tavolinën e bisedimeve në Bruksel. Shefi i shtetit ka vlerësuar se ShBA-ja dhe BE-ja kanë bashkëpunim në këtë proces. Ai ka vlerësuar se ky bashkëpunim duhet të reflektojë edhe brenda në Kosovë që të ketë një unitet përballë dialogut me Serbinë

reciproke është e vetmja zgjidhje që garanton stabilitetin në rajon. "Dua të besoj se vetëm njohja reciproke me standardet e përcaktuara në kornizën e marrëveshjes eventuale që mund të arrihet mund të jetë mundësi e mirë dhe e vetmja që garanton stabilitetin në rajon, fqinjësinë e mirë mes dy vendeve tona dhe garanton të ardhmen evropiane edhe të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Thaçi.

Shefi i shtetit ka vlerësuar se ShBA-ja dhe BE-ja kanë bashkëpunim për këtë proces. "Edhe në takimin që kam zhvilluar në Bruksel me Lajçakun kemi pasur tema të njëjta. Edhe në Uashington po ashtu. Shoh koordinim edhe të BE-së dhe të ShBA-së. Është mesazh i mirë dhe inkurajues që të jemi unikë e të bashkuar përballë Serbisë. Kjo do ta

mundësonte edhe zhvillimin ekonomik", është shprehur Thaçi.

Këto komente presidenti Thaçi i bëri pas takimit me të dërguarin e posaçëm të Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, i cili po qëndron për vizitë në Kosovë. Ai ka thënë se me zyrtarin e lartë të BE-së ka pasur një takim korrekt dhe miqësor. "Mund të konkludoj se bashkëbisedimi ynë ka qenë korrekt, konstruktiv dhe bisedë e hapur e miqësore në drejtimin e gjetjes së mundësive për arritjen e marrëveshjes finale në mes të Kosovës dhe Serbisë që do të nënkuptonte njohje reciproke dhe mundësinë që Kosova të anëtarësohet në OKB", ka deklaruar Thaçi.

Lidhur me vizitën e tij në

Shtetet e Bashkuara dhe në Francë, ai ka thënë se gjatë takimeve joformale me autoritetet më të larta të ShBA-së dhe gjatë diskutimeve në Paris ka parë një koordinim më të lartë për çështjen e dialogut që, sipas Thaçit, duhet të reflektojë edhe brenda në Kosovë që të ketë një unitet përballë dialogut me Serbinë. Edhe në këtë adresim presidenti ka përmendur çështjen e liberalizimit të vizave. Ai i ka bërë thirrje BE-së që të lëvizë më shpejt rreth liberalizimit të vizave. "E ardhmja e vetme e Kosovës është që të jetë pjesë e NATO-s dhe BE-së dhe në këtë drejtim BE-ja duhet të lëvizë shpejt drejt liberalizimit të vizave sepse po ndodh padrejtësi dhe ndëshkim. Kosova i ka përmbushur të gjitha kriteret", ka deklaruar presidenti.

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 14 TETOR - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka kërkuar që në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë të ndërmerret nga Bashkimi Evropian, të vihet në tryezë të diskutimit mundësia e njohjes reciproke. Pas kthimit nga vizita në ShBA, në një konferencë për media ai ka

thënë se më nuk duhet të vazhdohet në Bruksel me dialog teknik. "Të hidhet në tryezë mundësia e diskutimit për njohjen reciproke dhe kjo duhet të jetë pika e parë e marrëveshjes pastaj çështjet e tjera vijnë më lehtë dhe jo të vazhdohet me çështje teknike që i kemi diskutuar tash e dhjetë vjet në Bruksel", ka deklaruar presidenti Thaçi. Ai ka vlerësuar se njohja

LAJÇAKU TAKOI LIDERËT POLITIKË, TEMË DISKUTIMI DIALOGU KOSOVË - SERBI

procesin e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. Pas takimit, ai ka thënë se PDK-ja e mbështetë procesin e dialogut dhe është e vetmja që ka propozuar një platformë për këtë çështje. “Është inkurajues pozicioni i përfaqësuesit special të BE-së, Miroslav Lajçak, që në emër të Bashkimit Evropian ka një agjendë të qartë për ta përmbyllur dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë me një marrëveshje finale. Partia Demokratike e Kosovës do të vazhdojë që si opozitë të japë kontribut, ku si bazë mbështetje ka vullnetin e qytetarëve dhe Kushtetutën”, ka thënë Veseli.

Edhe kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka prituri në takim emisarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak.



është gati që t'i marrë përgjegjësitë, me garancitë e partnerëve strategjikë. I shpreha z. Lajçak qëndrimin se

finale. Çdo zgjatje e procesit nuk i ndihmon paqes dhe stabilitetit në rajon”, ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në “Facebook”.

Një ditë më parë emisari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, ka takuar kryetaren e Kuvendit, Vjosa Osmani dhe kryeministrin Avdullah Hoti. Kryeministri Hoti ka bërë me dije se temë diskutimi gjatë këtij takimi ishte procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, i cili, sipas tij, duhet të rezultojë me njohje reciproke. “Duhet të arrijmë një marrëveshje përfundimtare me njohje reciproke, për normalizim të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona, në mënyrë që të mbyllim një kapitull dhe ta sigurojmë perspektivën eurointegruese”, ka deklaruar Hoti.

Kryeministri Hoti e vlerëson lart angazhimin e Lajçakut dhe

ka shprehur gatishmërinë për rol konstruktiv të Qeverisë së Republikës së Kosovës në këtë proces. Emisari i BE-së do të qëndrojë në Kosovë edhe të enjten, ku në fund të vizitës pritet t'u drejtohet edhe gazetarëve.

Është bërë me dije se pas vizitës në Kosovë, Lajçak do ta vizitojë edhe Serbinë.

Vizita e Lajçakut në Kosovë dhe Serbi vjen menjëherë pas adresimit të tij, ditën e hënë në Luksemburg, për ministrat e Jashtëm të BE-së, për dialogun Kosovë - Serbi.

Përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka theksuar se dialogu ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është një proces kompleks, por ai ka shprehur bindjen se arritja e një marrëveshjeje finale është çështje muajsh e jo vitesh.

Pas takimit me presidentin Thaçi, i dërguari i BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak, ka takuar liderët e




partive politike. Emisari i BE-së këto takime i ka vlerësuar si të frytshme për procesin e dialogut Kosovë - Serbi. “Kisha një takim të mirë dhe jashtëzakonisht të frytshëm me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi. U pajtuam që Kosova ka nevojë për dialog dhe për marrëveshje në gjithëpërfshirëse”, ka shkruar Lajçaku në llogarinë e vet në “Twitter”.

Më pas zyrtari i BE-së i ka shkruar në parti kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Ky i fundit ka treguar se në takim me përfaqësuesin e BE-së, Miroslav Lajçak, kanë folur për

Haradinaj ka thënë se në diskutimin me diplomatin sllovak i ka shprehur atij qëndrimin se BE-ja duhet t'i përshpejtojë përpjekjet për marrëveshje finale me njohje reciproke. “Prita në takim përfaqësuesin special të BE-së për dialogun, z. Miroslav Lajçak, me të cilin diskutuam për zhvillimet dhe progresin e dialogut. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës qëndron e përkushtuar për procesin e dialogut, i cili përfundon me njohjen reciproke në kufijtë ekzistues. Marrëveshja e 4 shtatorit e arritur në Shtëpinë e Bardhë është tregues se Kosova

Bashkimi Evropian duhet t'i përshpejtojë përpjekjet dhe se është koha për marrëveshje



200 ushtarë të KFOR-it realizojnë një ushtrim për situatat emergjente

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

GJAKOVË, 14 TETOR - Më shumë se 200 ushtarë të KFOR-it me 50 automjete dhe dy helikopterë me shumë role morën pjesë në një testim që synonte provat e menaxhimit të situatave emergjente dhe procedurat e zbatueshme të komandës dhe kontrollit dhe komunikimit midis njësive.

Ushtrimi, i quajtur "Stuhia perëndimore", u organizua nga Komanda Rajonale Perëndimore e udhëhequr nga Italia dhe u zhvillua në fushën ajrore të Gjakovës. Ai përbëhej



nga simulime reale të kontrollit të turmës dhe trazirave dhe evakuimi i personelit ushtarak

të cilat u kryen nga ushtarë të Italisë, Polonisë, Hungarisë, Austrisë, Moldavisë, Sllovenisë

dhe Turqisë.

Njësitë nga komandat rajonale të KFOR-it, Batalioni i Rezervës Taktike dhe Njësia e Specializuar Shumëkombëshe u përfshinë në trajnim, i cili përfshiu katër faza: mbikëqyrja ajrore, vendosja e kordonëve dhe pikave të vëzhgimit, futja e trupave të helikopterëve dhe evakuimi i personelit mes trazirave.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajori Michele Risi, ka vëzhguar stërvitjen së bashku me përfaqësuesit e misionit evropian EULEX dhe Policinë e Kosovës, së bashku me kolonel Eric Riley dhe kolonel Gianluca

Figus, të cilët respektivisht udhëheqin Komandat Rajonale të KFOR-it në Lindje dhe Perëndim.

Misioni i KFOR-it, i udhëhequr nga NATO-ja, është reaguesi i tretë i sigurisë pas Policisë së Kosovës dhe EULEX-it dhe po kryen rregullisht stërvitje me të gjitha njësitë e saj për të ruajtur një nivel të lartë të gatishmërisë, në mënyrë që të përmbushë misionin e tij për të kontribuar në një mjedis të qetë dhe të sigurt dhe lirinë e lëvizje për të gjithë qytetarët në Kosovë, siç është mandatuar nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Reçica premtion mbështetje për familjet me gjendje të rëndë sociale

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të mërkurën ka marrë pjesë në prezantimin e Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të OKB-së 2021-2025, ku MPMS-ja është e angazhuar për t'i adresuar sfidat dhe problemet që dalin nga dy prej 17 objektivave sa janë gjithsej pjesë e kësaj kornize. Lidhur me objektivin e parë "Eliminimin e varfërisë në të gjitha format kudo", ministri Reçica tha se në bashkëpunim edhe me partnerët e tjerë


ndërkombëtarë do të angazhohet për t'i mbështetur grupet e cënueshme, familjet në gjendje të rëndë sociale etj. "Konkretisht, ne tashmë e kemi miratuar në qeveri edhe konceptdokumentin që i hap rrugë hartimit të një ligji të ri të skemës së ndihmës sociale, në mënyrë që të kemi rritje të numrit të përfituesve të kësaj skeme dhe njëkohësisht zvogëlim të varfërisë", ka thënë ai.

Ndërsa sa i përket objektivit të pestë, "Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave", ministri

Reçica ka theksuar se MPMS-ja është duke u angazhuar që sa më parë të miratojë dy ligje tejet të rëndësishme dhe të domosdoshme: Ligjin e ri të punës dhe Ligjin për pushimin e lehonisë dhe prindëror. Për t'i jetësuar objektivat që dalin nga kjo kornizë dhe me qëllim të zbatimit të indikatorëve të synuar, ministri Reçica nënvizoi se duhet të kemi një bashkëpunim sa më konkret në mes të nivelit qendror dhe lokal, duke përfshirë këtu edhe një bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Kosovës.



Osmani mori pjesë në forumin parlamentar ku u diskutua për zhvillimet globale



PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka marrë pjesë në Forumin Virtual Global Parlamentar, të organizuar nga Rrjeti Parlamentar i Bankës Botërore dhe i Fondit Monetar Ndërkombëtar. Ky forum u mundëson parlamentarëve nga vende të ndryshme të botës të diskutojnë për zhvillimet globale. Osmani dhe homologë të saj nga Norvegjia, Meksika, Bangladeshi, në prani edhe të

rreth 100 parlamentarëve të tjerë, diskutuan për mobilizimin e ligjvënësve globalë në procesin e avokimit për barazinë gjinore, si dhe përfshirjen e grave në procesin e rimëkëmbjes nga pandemia Covid-19.

Osmani ka përmendur sfidat me të cilat përballen gratë në leadership përgjatë krizës së pandemisë si dhe ndikimin e polarizimit politik në zhvillimin e proceseve. Sipas saj, aftësia për të dëgjuar qytetarin dhe për

ta trajtuar si partner në përballje me pandeminë kontribuoi në menaxhim të suksesshëm në vendet e drejtuara nga gratë. Më tej, Osmani ka thënë se, përkundër progresit të shënuar si shoqëri, pandemia nxori në pah problemet me barazinë gjinore. Rritja e rasteve të raportuara për dhunë në familje dhe humbja e vendeve të punës nga gratë, sipas saj, janë indikatorë që kërkojnë vëmendjen e duhur nga institucionet.

Ministria e Arsimit ka zhvilluar modul të ri për regjistrim të rasteve me Covid-19 në shkolla

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Ministria e Arsimit dhe Shkencës, e përkrahur nga UNICEF-i, ka zhvilluar një modul të ri për regjistrim të rasteve të dyshuara dhe të konfirmuara me Covid-19 të nxënësve dhe personelit arsimor. Këtë aplikacion (Sistemi për regjistrimin e

rasteve me Covid), MASH e ka zhvilluar me qëllim të krijimit të lehtësirave për marrjen e informatave nga terreni për situatën pandemike në shkolla në kohë reale, informata të cilat do ta lehtësojnë punën e task forcave në nivel të shkollave, të komunave dhe të ministrisë

për përcjelljen e procesit mësimor në kushte pandemie. MASH-i ka kërkuar nga të gjitha shkollat, respektivisht DKA-të, që të raportojnë sa i përket situatës pandemike në shkolla për çdo ditë për rastet e dyshuara dhe të konfirmuara me Covid-19.



Raporti 24-orësh i IKShPK-së: Një i vdekur, 55 të shëruar dhe 80 raste të reja me Covid-19

Rritet numri i rasteve me Covid-19, Hoti paralajmëron masa ekstreme

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë ka vdekur një person nga Covid-19 si dhe janë paraqitur 80 raste të reja, duke shënuar një rritje të lehtë të infektiveve me këtë virus. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar edhe 55 persona, duke e çuar në 14 460 numrin e përgjithshëm të të shëruarave nga Covidi. Ky institut ka bërë me dije se në Kosovë janë edhe 1 315 raste aktive me Covid-19



**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 TETOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë 24 orëve të fundit ka vdekur një person si pasojë e infektimit me Covid-19. Po ashtu, IKShPK-ja ka njoftuar se gjatë kësaj periudhe kohore ka njoftuar se janë paraqitur 80 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 55 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 650 mostra të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 80 raste pozitive. Brenda 24 orëve është raportuar një rast i vdekjes me Covid. Numri total i rasteve pozitive është 16 425 raste nga 76 623 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 650 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 55 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 14 460 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 315", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar numrin e rasteve sipas komunave në nivel vendi.

"Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 17 raste, komuna Pejë 10 raste, komuna Podujevë 10 raste, komuna Fushë-Kosovë 8 raste, komuna Gjakovë 7 raste, komuna Gjilan 6 raste, komuna Prizren 5 raste, komuna Suharekë 4 raste, komuna Shtime 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Drenas 2 raste, komuna Ferizaj 2 raste dhe me nga një rast komunat Klinë, Skenderaj, Viti dhe Vushtrri. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjienën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja. Ndërsa kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka paralajmëruar për një mbyllje të re totale në vend, nëse nuk respektohen masat e ofruara në luftë kundër pandemisë Covid-19. Hoti ka pranuar se trendi në të cilin gjendemi del të jetë shqetësues sa iu përket rasteve por, sipas tij, gjendja mund të rëndohet edhe më shumë nëse nuk merren parasysh masat mbrojtëse anti-Covid. "Rreziku është real që nëse shkon në këtë trend, që të marrim masa më shtrenguese në dy tri javët e ardhshme. Rreziku është shumë real që për dy deri në tri javët, të detyrohemi të marrim masa ekstreme. Me respektimin strikt të masave ne mund ta

mirëmbajmë këtë gjendje. Nuk duam t'i shqetësojmë bizneset dhe qytetarët, por është në interes të tyre t'i respektojnë këto masa", ka thënë Hoti pas takimit me drejtuesit e institucioneve shëndetësore dhe të sigurisë.

Zemaj: OBSH-ja mbetet partnerja jonë strategjike për luftimin e pandemisë

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur në takim Abëbayehu Assefa Mengistu, koordinator për Ballkanin Perëndimor dhe Moldavinë i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH) si dhe zyrtarë të tjerë të kësaj organizate, me të cilët ka biseduar rreth menaxhimit të situatës epidemiologjike në vend dhe në rajonin e Ballkanit. Me këtë rast, Zemaj ka thënë se OBSH-ja mbetet partnere e Kosovës për luftimin e pandemisë Covid-19. "OBSH-ja mbetet partnerja jonë strategjike në luftimin e pandemisë duke na qëndruar afër gjatë kësaj kohe dhe asistuar si në përgatitjen e 'Manualit për mbrojtje nga përhapja e Covid-19', me donacione të rëndësishme, përfshirë këtu edhe

aparaturën për RT-PCR, të sjellë së fundi, me çka IKShPK-së i janë shtuar kapacitetet për testime molekulare për Covid-19. Me OBSH-në dhe partnerët e tjerë po zhvillojmë aleanca edhe për sigurimin e vaksinave kundër Covid-19, kur të njëjtat të jenë aprovuar për përdorim. Shpreha falënderimin tim për përkrahjen e rëndësishme që OBSH-ja po ia

ofron Kosovës, ndërsa z. Abëbayehu Assefa Mengistu e vlerësoi lart menaxhimin e pandemisë në Kosovë", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook". Po ashtu, Zemaj të mërkurën është takuar me kryetarin e LDK-së, Isa Mustafa, me të cilin ka biseduar për situatën epidemiologjike dhe për prioritetet e ministrisë që drejton.

KFOS-i i dhuron MSh-së 100 mijë teste molekulare

Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) ka dhuruar donacione 100 mijë teste molekulare dhe pajisje të tjera për Ministrinë e Shëndetësisë. Këtë donacion e ka mirëpritur ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili ka thënë se me këtë donacion që ka vlerë 1.5 milion dollarësh rritet fuqia testuese. Ai ka theksuar se ky donacion na gëzon të

gjithëve sepse ndikon në mobilizim për fazat e mëtutjeshme. Ndonëse ka thënë se situata pandemike është e qetë, sipas tij, kujdesi nuk duhet të mungojë. Kurse drejtori ekzekutiv i KFOS-it, Luan Shllaku, ka thënë se këtë vit është shtuar në agjendën e tyre ndihma për institucionet e Kosovës. Ai ka thënë se ky grant është realizuar për një periudhë të shkurtër kohore.

Prezantohet brendi i platformës turistike të Prishtinës

Prishtinë, 14 tetor - Komuna e Prishtinës ka bërë prezantimin e brendit dhe të platformës informuese turistike. Luljeta

Bashota ka thënë se Prishtina ka potencial ta ketë ofertën e vet turistike. "Jemi mbledhur këtu për projektet më të

dashura. Ka mundimin e vet secili projekt, por si ky që ka shumë ngjyra ka kënaqësi realizimi. Prishtina ka potencial ta

ketë ofertën e vet turistike. Ne duhet ta tregojmë mirëpritjen dhe dashurinë që përcjell Prishtina", ka thënë Bashota.



Bajrami: Nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike janë ndarë mbi 245 milionë euro



Prishtinë, 14 tetor - Mbi 245 milionë euro janë ndarë deri më tani nga qeveria për masat fiskale të marra për t'iu përgjigjur situatës me pandeminë Covid-19. Kështu ka bërë me dije ministrja e Financave, Hykmete Bajrami, gjatë raportimit në Komisionin për Buxhet dhe Transfere. "Nga 365 milionë euro të pakos për rimëkëmbje ekonomike janë ndarë deri tash 197 milionë euro, ndërsa nga fillimi i pandemisë me masat emergjente dhe nga Fondi për Rimëkëmbje Ekonomike janë ndarë deri tash mbi 245 milionë euro", ka thënë Bajrami.

Po ashtu, Bajrami ka theksuar se të martën janë ekzekutuar mbi 60 milionë euro për bizneset në linjën e subvencionimit të pagave për mbi 208 mijë të punësuar në sektorin privat. Më tutje, ajo ka thënë se nga të gjitha masat mbështetëse të qeverisë, janë mbi 400 mijë përfitues. Ndërsa zëvendëskryetari i Komisionit

për Buxhet dhe Transfere nga radhët e AAK-së, Gazmend Abrashi, ka komplimentuar zbatimin e planit dhe fondit të rimëkëmbjes ekonomike dhe ekzekutimit të mjeteve për masat mbështetëse nga qeveria.

Në anën tjetër, anëtarja e këtij komisioni nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se mjetet e ndara nuk janë bërë nga ligji i miratuar në parim ditë më parë (Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike). Në këtë drejtim ajo e ka pyetur ministren Bajrami pse është pritur tre muaj dhe nuk janë ekzekutuar mjetet që prej kur është miratuar rishikimi i buxhetit 2020.

Kurse anëtari i Komisionit për Buxhet dhe Transfere nga radhët e PDK-së, Bedri Hamza, ka thënë se masat e ndërmarra nga qeveria janë të vonuara dhe të pamjaftueshme, teksa ka shtuar se përtej kësaj janë edhe pa bazë ligjore.

Rukiqi: Vetëm 35 për qind e bizneseve presin ta rrisin numrin e punëtorëve

PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, e ka vlerësuar të pakënaqshme gjendjen e bizneseve të cilat janë goditur nga pandemia. Ai ka thënë se janë vetëm 35 për qind e bizneseve që presin ta rrisin numrin e punëtorëve. "Tremujori i dytë i këtij viti tregon për një gjendje të pakënaqshme të bizneseve që nga paslufta. Rreth 80 për qind e bizneseve e kanë vlerësuar gjendjen e tyre të pakënaqshme.

Nëse e krahasojmë me tremujorin e parë të këtij viti është një pakënaqësi 47 për qind më e lartë", ka thënë Rukiqi. Ai ka theksuar se ky është bilanci më negativ pasi që shumica e kompanive nuk presin të hapin vende të reja të punës. "Pjesa më e madhe e kompanive në gjashtë muajt e ardhshëm presin që situata biznesore të përkeqësohet. Për indikatorin e konfidencës është tremujori më negativ, sepse ka rënie shqetësuese", ka thënë Rukiqi.



Hoti: Qeveria do t'i trajtojë seriozisht sfidat e pensionistëve



PRISHTINË, 14 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të mërkurën përfaqësuesit e Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës, me të cilët ka biseduar për kushtet dhe sfidat që ata përballen, veçanërisht pas situ-

atës së krijuar nga pandemia Covid-19. Me këtë rast, Hoti i ka siguruar pensionistët se qeveria do t'u qëndrojë afër dhe do të angazhohet për përmirësimin e kushteve të tyre. "Qeveria është e përkushtuar dhe do t'u qëndrojë afër të gjithë qytetarëve, si dhe po i trajton me seriozitet sfidat e tyre, përf-

shirë këtu edhe pensionistët të cilët kanë dhënë kontribut të madh për zhvillimin e shoqërisë", ka theksuar Hoti. Ndërsa përfaqësuesit e Lidhjes së Pensionistëve kanë falënderuar kryeministrin Hoti për pritjen, si dhe e kanë vlerësuar angazhimin e tij për trajtim të kërkesave të tyre.

OEAK-u: Pandemia krijoi pasiguri ekonomike te bizneset në pronësi të grave



Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ka publikuar të mërkurën studimin mbi ndikimin e pandemisë Covid-19 në ndërmarrjet në pronësi të grave. Sipas këtij studimi, pandemia ka prodhuar pasiguri ekonomike, veçanërisht te bizneset që janë në pronësi të grave në Kosovë

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 TETOR - Pasiguria ekonomike, e krijuar nga pandemia Covid-19, ka prodhuar rezultate negative për të gjitha bizneset dhe industrinë, me theks të veçantë te grupet më të ndjeshme siç janë bizneset në pronësi të grave. Kështu është thënë të mërkurën gjatë publikimit të studimit: "Ndikimi i Covid-19 në ndërmarrjet në pronësi të grave në Kosovë", i cili është realizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë (OEAK). Autorja e studimit, Ardita

Hajra, zyrtare e politikave në Odën Ekonomike Amerikane, e cila ka bërë edhe prezantimin e të gjeturave kryesore të studimit, ka thënë se i njëjti studim synon të ofrojë njohuri mbi trendet aktualë, format dhe nivelin e dëmeve të shkaktuara nga pandemia, si dhe identifikimin e problemeve kryesore me të cilat po përballen gratë gjatë kësaj periudhe mjaft të vështirë. Sipas këtij studimi, sfida më e madhe për gratë pronare ka qenë mirëqenia ekonomike me 40.94 për qind, e pasuar nga nevoja për përkujdesje të shtuar ndaj familjes, me 28.19

për qind. Siç ka zbuluar ky studim, një e gjetur tejet shqetësuese është edhe shifra e bizneseve të mbyllura plotësisht gjatë fazës së izolimit, me 65 për qind, ndërsa të dhënat tregojnë se ka pasur një rënie të lartë të përqindjes në shitje, me rreth 90 për qind. Amendamenti i Ligjit të Punës mbetet ende thelbësor për nxitjen e punësimit të grave, ku studimi ka gjetur se rreth 90 për qind e grave të anketuara janë optimiste se ndryshimi i këtij ligji do ta nxiste rritjen e numrit të grave të punësuar. Edhe pse gratë përballen me sfida dhe pengesa specifike dhe ato nënperfaqësohen në pozita udhëheqëse, 35.71 për qind e tyre besojnë se përmirësimi i ambientit të të bërit biznes në përgjithësi do ta rriste drejtpërdrejt pjesëmarrjen e grave në treg, pasi probleme të ndryshme në biznes janë të ngjashme si për gratë ashtu edhe për burrat. Siç kanë

theksuar të gjeturat e studimit të OEAK-ut, grantet e veçanta nga qeveria me 74.81 për qind do të ishin një masë ideale për rimëkëmbjen e bizneseve të grave.

Gjatë tryezës së diskutimit për të njëjtën temë, Mrika Gashi, drejtoreshë ekzekutive në AZhR, njëkohësisht anëtare e bordit të guvernatorëve të Odës Amerikane, ka theksuar se duhet të rritet ndërgjegjësimi si dhe qasja e grave në informata për aplikime në grante, sidomos për gratë në zonat rurale të cilat kanë qasje më të limituara në resurset e nevojshme për zhvillimin e bizneseve të tyre. Gashi ka potencuar se mbështetja përmes fondeve të ofruara nga Qeveria e Kosovës, sado e dobishme, fatkeqësisht është e pamjaftueshme. Më tutje, ajo ka bërë thirrje për organizimin e sesioneve informuese dhe trajnimeve profesionale, promovimin e grave në biznes si dhe fuqizimin e pozitës së tyre në tregun

vendor, rajonal dhe atë ndërkombëtar.

Kurse Besa Ilazi, specialiste e menaxhimit të projektit në zyrën e USAID-it për rritje ekonomike, ka theksuar se në Kosovë pjesëmarrja e grave në fuqinë punëtore është mjaft e ulët, ndërsa fuqizimi ekonomik i grave është thelbësor për zhvillimin e vendit. Ilazi ka informuar pjesëmarrësit për strategjinë e USAID-it për pesë vjetet e ardhshëm, e cila fokus kryesor ka zhvillimin gjithëpërfshirës, pa dallime gjinore, etnike apo në moshë. Sipas saj, kjo strategji synon të sigurojë përfshirje të barabartë në ekonomi, ndërsa në kuadër të saj gratë ndërmarrëse do të ndihmohen përmes asistencës teknike. Po ashtu, Ilazi ka përmendur edhe një projekt tjetër i cili synon ta risë praninë e grave në tregun ndërkombëtar, me fokus në eksport, përkatësisht në sektorin e teknologjisë informative, atë të përpunimit të drurit dhe të ushqimit.

ATK-ja vlerësohet lart në raportin e BE-së për Kosovën 2020

PRISHTINË, 14 TETOR - Bashkimi Evropian si çdo vit tjetër ka publikuar raportin 2020 për Kosovën, në të cilin sa iu përket të arriturve në pjesën e tatimeve, kanë vlerësuar reformat në ATK, si reformimin e strukturës organizative, përmirësimin e proceseve për menaxhimin e mbledhjes së borxheve, si dhe trajtimin e sektorëve me risk të lartë. Po ashtu, raporti në fjalë nënvizon edhe inkasimin e të hyrave për vitin 2019, për të cilat thuhet se është regjistruar progres i mirë

në mbledhjen e tatimeve në vitin e kaluar, ku mbledhja e përgjithshme e të hyrave në raport me vitin 2018 është më e lartë për 10.4 për qind. Raporti, ndër të tjera, vlerëson edhe zvogëlimin e stokut të borxheve, për të cilat thuhet se ATK-ja ka shënuar përparim të konsiderueshëm në mbledhjen e borxheve tatimore për 44.5 për qind. Veç të tjerash, raporti flet edhe për strategjinë për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së kontrolleve, si dhe për uljen e kohës mesatare të

rimbursimit të TVSh-së në 20 ditë.

Si çdoherë tjetër, edhe këtë herë është vlerësuar avancimi i shërbimeve ndaj tatimpaguesve, me theks zgjerimi i shërbimeve përmes sistemit elektronik EDI. Raporti i BE-së për Kosovën është instrument me anë të të cilit Bashkimi Evropian mat përparimin e një vendi në zbatimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim dhe për përmirësimin e agjendës evropiane brenda vitit kalendarik.



Diskutohet për hartimin e strategjisë komunale për trajtimin e dhunës në familje

FERIZAJ, 14 TETOR (ER) - Nën kryetari i Komunës së Ferizajt, Arton Gavazi, ka pritur të mërkurën në takim, përfaqësues të OSBE-së, ku temë diskutimi ishte funksionimi i mekanizmit komunal kundër dhunës në familje, trupë kjo e themeluar vite më parë me qëllim të koordinimit të veprimeve institucionale për adresimin e dhunës në familje. Nën kryetari Gavazi, pasi ka paraqitur veprimet e ndërmarra në këtë

fushë, është zotuar edhe për shtimin e bashkëpunimit si dhe për dinamizimin e veprimeve në dobi të funksionalizimit të plotë të kësaj trupe. Më tutje, ai ka thënë se rezultat i këtij synimi është hartimi i Planit të veprimit kundër dhunës në familje si dhe hartimi i Strategjisë komunale kundër dhunës në familje, lehtësimin e mbështetjes për të cilën është e gatshme ta ofrojë OSBE-ja.



Komuna e Kamenicës do të japë 200 euro për foshnjat e porsalindura



KAMENICË, 14 TETOR (ER) - Komuna e Kamenicës ka bërë me dije se tani e tutje çiftet do të subvencionohen me nga 200 euro si mbështetje për foshnjat e porsalindura. Me këtë rast, kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, ka thënë se lindja dhe rritja e

fëmijëve është sfidë e përgjegjësi e madhe, andaj çiftet tani e tutje do të subvencionohen me nga 200 euro. "Krijimi i familjes është një nga vendimet më të rëndësishme për çdo çift. Lindja dhe rritja e fëmijëve është lumturi, por edhe

përgjegjësi dhe sfidë e madhe. Sa më të vështira kushtet ekonomike, aq më e madhe sfida. Prandaj, tani e tutje do t'i subvencionojmë çiftet me nga 200 euro si mbështetje për foshnjat e porsalindura", ka thënë Kastrati.

Komuna e Drenasit pranon 60 komposterë shtëpiakë

DRENAS, 14 TETOR (ER) - Komuna e Drenasit, përkatësisht Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjatë kësaj jave ka bërë pranimin e 60 komposterëve në kuadër të projektit "Kompostimi shtëpiak në 6 komuna", në bashkëfinansim në mes të komunave dhe GIZ-SMS "Green Art Center".

Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapa, ka thënë se ky projekt me rëndësi do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Kompostimi shtëpiak është me rëndësi për qytetarët e Drenasit pasi ka për qëllim reduktimin e sasisë totale të mbetjeve që depozitohen në deponi", ka thënë ajo.



Fillon asfaltimi i dhjetë rrugëve në fshatin Shkozë

MALISHEVË, 14 TETOR (ER) - Në kuadër të realizimit të projekteve kapitale dhe të investimeve në infrastrukturën e përgjithshme në vendbanimet e Komunës së Malishevës, në fshatin Shkozë ka filluar asfaltimi i dhjetë rrugëve nëpër lagje. Asfaltimin e këtyre rrugëve e kanë parë nga afër edhe kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina.

Kryetari Begaj i ka uruar banorët e fshatit Shkozë për rregullimin e këtyre rrugëve si dhe ka thënë se në këtë fshat po bëhen edhe investime të tjera. "Urime banorë të Shkozës! I gëzofshi këto rrugë të reja!", ka thënë Begaj. Ndërsa drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, ka bërë me dije se këto dhjetë rrugë dhe investime të tjera që janë duke u bërë në Shkozë, mundësohen nga buxheti i Komunës së Malishevës.



Shengeni made in ShBA ul arsyeshmërinë e hegjemonisë serbe në armatim dhe i kthen pretendimet luftarake të Serbisë në marrëdhënie ekonomike



Shkruan: Hisen BERISHA

Marrëveshja e Uashingtonit është e rëndësishme në aspektin zhvillimor politik e diplomatik, por detajet që po kërkojnë të dihen nga PDK-ja janë të rëndësishme për ndërtimin e politikave zhvillimore që konseguojnë në implementim.

Shengeni e ul arsyeshmërinë e hegjemonisë serbe në armatim. Po ashtu, Shengeni Made in ShBA e bën të parëndësishëm asociacionin e komunave me shumicë serbe, por me krehjen

kushtetuese. Sa i përket “Shengenit”, Made in ShBA, shqiptarët janë në themel të tij e jo t’i bashkëngjiten në proces siç ofruan nismëtarët e “Minishengenit” ballkanik made in Vuçiq - Rama.

Ky asociacion me vërejtjet e Gjykatës Kushtetuese dhe Shengenit me standardet e ShBA-së do t’i detyrojë serbët dhe Serbinë t’i ulin armët ruse në Serbi dhe ta orientojnë buxhetin në ekonomi, tregti e mirëqenie e jo në armatim. Shengeni i ul dhe i bën të parëndësishme më.

Ekzistenca e tyre, pra asociacionit dhe Shengenit, e shuan kushtin politik në të cilin thirret Vuçiqi siç heqja e tarifave doganore, për t’u kthyer pretendimet luftarake në marrëdhënie ekonomike.

Pra asociacioni i formuar sipas

Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, statutin e së cilës e ka formuar një ekip shumetnik i cili duhet krehur prapë në Gjykatën Kushtetuese, duhet të jetë edhe kusht për njohje të Kosovës nga Serbia.

Pikë e nxehtë që është e pakalueshme do të jetë edhe pretendimi i kthimit të serbëve kolon dhe që nga viti 1975, dhe pretendimi për t’u kthyer edhe pronat e tyre. Kjo është pa asnjë sens dhe nuk është dashur të jetë pjesë e debateve politike dhe as çfarëdo marrëveshjeje nëse i referohemi rrugëtimit të Kosovës nga paslufta e dytë botërore apo edhe më herët që nga luftërat ballkanike, me theks do të shohim se nuk mund të flitet për kthim të të zhvendosurve serbë nga Kosova, gjoja në pasuritë e tyre. Kjo nuk qëndron dhe do

studim të matur. Janë disa periudha para dhe gjatë e pas Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore, me theks pas vitit 1990, vendosja e serbëve nga trevat e tjera të Jugosllavisë në territorin e Kosovës si kolon nëpër kolonitë e ndërtuara enkas për ta në tokat shqiptare publike të krijuara me reformën agrare të pas Luftës së Dytë Botërore apo private në kohën e okupimit klasik serbo-jugosllav komunist.

Po të njëjtin sens e përkushtim kërkon situata që po krijohet me ndërtimin e “luginës së diellit” që po ndërtohet në të njëjtën procedurë dhe për të njëjtin qëllim si ato që bëheshin në kohën e regjimit të Millosheviqit. E fundit, njerëzit që i kanë tjetërsuar për para pronat e tyre, ku t’u gjendet tokë? Apo t’u merret pronarëve

të tanishëm legalë? Kjo do të prodhojë konsekuenca të paparashikueshme, kur dihet fakti se qeveritarët serbë kanë bërë shumë transaksione fiktive dhe kanë krijuar dokumentacion të “zyrtarizuar” formalisht, por tërësisht fiktiv për pronave të synuara me pronarë shqiptarë. Këto e të tjera detaje janë ndër finesat që PDK-ja po kërkon të sqarohen dhe me këtë edhe një “kokë turku”.

Pra, detajet e marrëveshjes nuk janë sqaruar apo nuk janë kundërshtuar në parim. Kurse sa iu përket pikave të tjera kyçe në marrëveshje, gjegjësisht “dokumentin e zotimeve”, ato vërtet, si të tilla, janë të karakterit ekonomik, por në implementim i japin Kosovës rolin e shtetit si subjekt në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Reagim i KMDLNj-së

KRYEQYTETI I QENVE!

Kohë më parë qen të kryeqytetit të Kosovës në Prishtinë sulmuan një nxënës të shkollës fillore sikur edhe një grua dhe vetëm intervenimi i kalimtarëve të rastit i shpëtoi nga më e keqja. Edhe më herët po këta qen të kryeqytetit kanë sulmuar persona të moshuar apo qytetarë të tjerë duke ua bërë të pasigurt lëvizjen e tyre. Vetëm pas këtyre sulmeve dëgjohet zëri i autoriteteve komunale, më shumë arsyetues sesa parandalues. KMDLNj edhe më herët ka tërhequr vërejtjen për rrezikun me të cilën përballen qytetarët e Prishtinës nga qentë endacakë, numri i të cilëve kohën e fundit është rritur shumë dhe se janë të vendosur kryesisht në qendër të kryeqytetit përkatësisht në sheshin “Nënë Tereza” apo rreth kontejnerëve ku vendosen mbeturinat dhe ku kërkojnë ushqime. Natyrisht se KMDLNj ka mirëkuptim për autoritetet e kryeqytetit që nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm profesional dhe material për trajtimin dhe strehimin e përhershëm të qenve endacakë mirëpo, në anën tjetër, kjo situatë që nuk po menaxhohet si duhet, për arsye objektive dhe subjektive mund ta rrezikojë seriozisht shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve të Prishtinës.

Gjithashtu, organizatat që merren me mbrojtjen, në rastin konkret të

qenve endacakë, duket se nuk po kanë fonde të mjaftueshme që ta realizojnë programin e tyre. Problemi i qenve endacakë në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë apo trajtohet si çështje që iu takon vetëm institucioneve të kryeqytetit, por se duhet që edhe ministrinë përkatëse të kontribuojnë për zgjidhjen e këtij problemi. Përkundër faktit se komuna e Prishtinës i ka shenjzuar qentë e kryeqytetit sikur që e ka bërë sterilizimin për ta mbajtur nën kontroll numrin e tyre, vërehet se rrugëve të kryeqytetit ka qen të ardhur e që nuk janë të shenjzuar e që nënkupton se as që janë trajtuar me vaksina apo është bërë sterilizimi i tyre. Komuna e Prishtinës, por edhe Qeveria e Kosovës, përmes ministrive përkatëse duhet të ndajë mjete shtesë për organizatat që merren me trajtimin dhe strehimin e qenve, ta rrisë kapacitetin e strehimoreve në mënyrë që të krijohen kushtet dhe mundësitë që qentë e kryeqytetit të trajtohen në kushte më të mira dhe të mos paraqesin rrezik për jetën dhe sigurinë e qytetarëve. Në të kundërtën, për çdo pësim eventual të qytetarëve të Prishtinës përgjegjësia do të adresohet tek autoritetet e kryeqytetit. Mungesa e ushqimit po i bënë qentë edhe më agresivë andaj komuna e Prishtinës deri në kohën kur të jetë në gjendje të bëjë një zgjedhje të përhershme



për qentë e kryeqytetit, do të duhej të sigurojë ushqime për qentë e kryeqytetit për të mbajtur nën kontroll agresivitetin e tyre. Përveç se këta qen po e rrezikojnë jetën dhe sigurinë e qytetarëve të Prishtinës, qarkullimi i tyre dhe vendosja në sheshet dhe rrugët kryesore të kryeqytetit të Kosovës po i krijon një pasqyrë të keqe. KMDLNj vlerëson se qentë e kryeqytetit duhet të trajtohen më mirë dhe krejtësisht duhet të zhvendosen nga qendra e Prishtinës dhe nga vet kryeqyteti. Aktualisht, sigurinë dhe lirinë e lëvizjes së qytetarëve të Prishtinës po e rrezikojnë qentë e kryeqytetit apo qentë e Shpendit sikur edhe ndërtimet e shumta që e kanë shndërruar kryeqytetin në Hiroshimë arkitektonike. Nuk ka vend në botë ku rrugëve kryesore

të kryeqytetit lëvizin gjatë 24 orëve betonjerkat dhe kamionët e shumë me dhe sikur edhe me materiale inerte dhe kur ndërtimet vazhdojnë edhe në orët e vona të natës. Mjetet e transporti për materiale inerte sikur edhe betonjerkat e shumta, përveçse e bllokojnë kryeqytetin, në shumë vende kanë dëmtuar rëndë infrastrukturën rrugore, gypat e kanalizimit dhe ujësjellësit duke u shkaktuar shumë probleme qytetarëve.

Gjatë fushatave parazgjedhore për zgjedhje lokale, kandidatët për kryetar të Prishtinës patën premtuar një Prishtinë metropolitane, rregullimin e transportit publik me tramvaj, ndërtimin e metros deri në Fushë Kosovë, hapësira të gjelbra dhe parqe, Shtëpinë e Operas,

parkingje të mjaftueshme nëntokësore dhe mbitokësore ndërkaq që nuk kanë qenë në gjendje ta ndërtojnë as edhe një WC të vetme publike. Tash, qartazi po duket se Prishtina është shndërruar në kryeqytet të qenve dhe mundësi e hatashme që përmes ndërtimeve të pakontrolluara të legalizohet mafia e ndërtimit e që në fakt po i riciklon paratë e pista dhe të fituara nga aktivitetet kriminale (një pjesë e tyre) ndryshe nuk mund të kuptohet ndërtimi aq i madh i banesave kurse çmimi i tyre asnjëherë nuk ulet në kohën që nuk ka nevojë për aq shumë banesa. Në mungesë të hapësirave të gjelbra dhe hapësirave për rekreacion, Prishtina po shndërrohet në varrezë masive arkitektonike.



Gjuha përcakton mënyrën se si e shohim botën

Nga: Nayantara DUTTA/BBC

Në këtë vit, çdo të mërkurë në mbrëmje e mësoja sërish hindishten, gjuhën time të tretë pas bengalishtes dhe anglishtes. Edhe pse ishte gjë e mirë të jem më e lidhur me kulturën time, u befasona dhe disi isha e zhgënjyer kur e zbulova strukturën gjinore të gjuhës time amtare. Anglishtja ka qenë gjithmonë parazgjedhja ime, meqë nuk ka aq shumë dallime të bazuara në gjini, kështu që me hindishten më është dashur të mësoj si të mendoj dhe si të flas në një mënyrë të re, në një mënyrë ku vazhdimisht jam e vetëdijshme për gjininë.

Historikisht, bota e ka gjininë mashkullore si të paracaktuar, një konstrukt që përforcohet përmes gjuhës. Si njerëz, identiteti ynë kolektiv kuptohet si mashkullor; ne e përdorim 'njeriun' për të përshkruar speciet tona, si dhe 'njerëzimin' si mënyrë për të na bashkuar. Në librin e saj *"Gratë e padukshme: Paragjykimi i të dhënave në një botë të krijuar për burra"*, Caroline Criado Perez shkruan: *"Të shohësh burrat si parazgjedhje, është thelbësore për strukturën e shoqërisë njerëzore"*. Kultura dhe gjuha jonë e ndjekin një

kornizë të përgjithshme mashkullore, ku, siç shpjegon ajo, *"paragjykimi i mashkullores është ngulitur aq fort në psikikën tonë sa që edhe fjalët, me të vërtetë të paanshme gjinore (si doktor ose aktori), lexohen si mashkullore"*. Në disa raste, forma mashkullore flet për të gjitha gjinitë: për shembull, në sistemin juridik të Indisë, dokumentet shkruhen në gjininë mashkullore, gjë që konsiderohet se përfshin gratë, përveç nëse specifikohet ndryshe. Në shumë mënyra, gjuha i reflekton dhe i krijon pabarazitë gjinore që ekzistojnë në shoqëri. Se si flasim kjo ndikon në mënyrën se si mendojmë dhe se si e interpretojmë botën përreth nesh. Pra, teksa jemi duke punuar për të riimagjinuar parazgjedhjet tona rreth gjinisë, për të ndërtuar një kulturë më të ndërgjegjshme, më të vetëdijshme e më përfshirëse shoqërore, ne gjithashtu duhet të llogarisim në gjuhën.

Gjuhët globale ndahen në tri kategori, në lidhje me gjininë: gjuhët gjinore si spanjishtja (ku emrat dhe përemrat kanë një gjini), gjuhët pa gjini si ajo mandarine (ku emrat dhe përemrat nuk kanë gjini të shënuar), si dhe gjuhët gjinore natyrore si anglishtja (me

përemra gjinorë dhe emra pa gjini). Struktura gjinore e gjuhës që flasim do ta ketë efektin që të na bëjë pak a shumë të vetëdijshëm për gjininë. Me gjuhë gjinore duhet të mendojmë për gjininë teksa bashkojmë një folje ose përdorim një emër, ndaj ka mundësi që stereotipat me bazë gjinore dhe strukturat e pushtetit gjinor të kenë më shumë gjasa të ndikojnë në mendimet dhe opinionet tona në lidhje me gjinitë?

Teksa e mësoja hindishten, një gjuhë gjinore, kuptova se duhej të tregoja respekt për burrat, ndonjëherë më shumë sesa për gratë. Nuk më lejohej të flisja me shokët dhe shoqet e mia të klasës në të njëjtën mënyrë: Me burrat u mësova ta përdorja shumësin e nderuar ("Aap kya kar raha hai?" mbi "Tu kya kar raha hai?" që të pyes se "çfarë po bën?"), por mund të tregoja respekt për gratë vetëm duke përdorur mbarese femërore ("Aap kya kar rahi hai?" mbi "Tu kya kar rahi hai?"). Megjithëse mund t'i adresojmë me respekt të dy gjinitë, nuk mund të përdorim të njëjtën strukturë gjuhësore, gjë që tërheq vëmendjen për gjininë e personit me të cilin po flasim. Në varësi të asaj se prej nga jemi dhe se si e mësuam gjuhën, kjo

mund të na mësojë të tregojmë respekt të barabartë ndaj burrave dhe grave, ose t'i trajtojmë ndryshe. Megjithëse gjuha zyrtare mund të lidhet me respektin, gjuha joformale mund të përdoret gjithashtu për të shprehur intimitet ose afekcion. Me hindishten, disa gra përdorin "aap", mënyrën me respekt për të thënë "ju", për t'iu referuar burrave të tyre, ndërsa burrat përdorin "tum", "ti" joformale për gratë e tyre dhe çiftet e tjera përdorin të njëjtën përemër për njëri-tjetrin.

Katër gjuhët më të folura gjinore në botë janë hindishtja, spanjishtja, frëngjishtja dhe arabishtja. Ato ndajnë shumë prej të njëjtave modele gjinore: mashkullore si gjinia e paracaktuar gramatikore, grupe me gjini të përziera që përdorin mbarese mashkullore dhe emra femërorë që rrjedhin nga versionet mashkullore. Përmes strukturës së tyre, ato theksojnë vëzhgimin e Criado Perezit për parazgjedhjen mashkullore. Për shembull, spanjishtja ndjek një mashkullore gjenerike kur është e paqartë nëse subjekti është mashkull apo femër; një shok mashkull është amigo dhe një shoqe (femër) është amiga, por një grup shokësh janë amigos. Paracaktimi mashkullor vlen edhe për grupet me gjini të

përziera, si amigos, të cilat përdorin mbarese mashkullore. E njëjta gjë vlen edhe për mbiemrat: një grup shoqesh të mira (femra) janë "buenas amigas", por posa të jetë një mashkull në grup do të jenë "buenos amigos". Është gjithashtu e qartë se mashkullorja është gjinia standarde në spanjishtë, pasi është forma e paracaktuar që përdoret në fjalorë.

Në arabisht, origjina e të gjitha fjalëve është versioni i tyre mashkullor. Kur u referoheni grave, fjalëve u shtohet mbarese femërore "taa marbuta" (), e cila tingëllon si "h". Fjalët si Kateb, "shkrimtar", nuk kërkojnë dallime kur përshkruajnë burrat, por nëse flasim për një shkrimtare, për femër, duhet të shtojmë fundin femëror "taa marbuta" (), Katebah, "shkrimtare femër". Pra, kur jemi duke folur me ose për gratë, jemi më të vetëdijshëm për identitetin e tyre gjinor, sepse nuk mund të përdorim mashkulloren e paracaktuar dhe duhet të ndryshojmë mënyrën e të folurit. Për më tepër, bashkimi mashkullor i fjalëve përdoret gjithashtu kur i referohemi çdo grupi që ka një mashkull të vetëm, pavarësisht nga gjinia e shumicës së grupit. Pra, kur i referohemi një grupi

me një shkrimtar mashkull dhe 100 shkrimtare femra, janë “shkrimtarë meshkuj” (Kottab), jo “shkrimtare femra” (Katebat). Gjuhët që flasim ndikojnë në mënyrën se si e ndërtojmë shoqërinë, madje mund të krijojnë precedentin për barazinë gjinore në sistemet tona shoqërore. Në një studim të vitit 2011, Jennifer Prewitt-Freilino, profesore dhe e asociuar në Shkollën e Dizajnit në Rod Ajllënd, së bashku me koleget zbuloi se vendet me gjuhë gjinore përjetuan pabarazi mesatare më të lartë gjinore. Studimi zbuloi gjithashtu se gjuhët natyrore gjinore, si anglishtja, përjetuan më së shumti barazi, megjithëse mund të pritet që gjuhët pa gjini të jenë më të barabarta.

“Historikisht, gjuha pa gjini mund të bëjë që mendjet e njerëzve të hidhen në mashkullore, pa e thirrur atë në mënyrë specifike (sikur kur supozojmë se termi “kongresist” i referohet një burri)”, thotë Prewitt-Freilino. “Kjo është arsyeja se pse kemi gjetur se gjuhët natyrore gjinore janë më të mira për këtë, sepse kur ato krijojnë gjuhë të reformuar, ndërtojnë fjalë të reja neutrale gjinore në gjuhën gjinore, e cila tërheq vëmendjen për korrigjimin e sistemit gjinor (dhe e bën më lehtë të njohësh paragjykimin)”.

Ishin disa avokime rreth reformës gjuhësore në vitet e fundit, veçanërisht në lidhje me frëngjishten dhe spanjishten, të cilat janë gjuhë shumë gjinore pa forma neutrale. Në disa vende që flasin spanjisht, njerëzit kanë krijuar mundësi neutrale gjinore për t'i bërë spanjishtet e tyre më përfshirëse përmes mbasesave si “-e”, “-@” dhe “-x”, të cilat sigurojnë fleksibilitet përtej binarit gjinor.

Në Spanjë është një nismë për të rishkruar Kushtetutën duke përdorur gjuhë neutrale gjinore (në vend të formës ekzistuese mashkullore) e që ka arritur deri në qeveri. Në Francë aktivistët kanë futur një stil të përzier gjinor të quajtur “écriture inclusive”, që ia shton të dy mbasesat gjinore një fjale për ta bërë neutrale ndaj gjinisë (ami e s). Institucionet gjithashtu po tregojnë mbështetje, bashkë me Bashkimin Evropian, duke krijuar një organ autonom të quajtur Instituti Evropian për Barazinë Gjinore që punon për të zbatuar politikën e bazuar në barazinë gjinore dhe madje financon hulumtimet rreth reformës gjuhësore.

“Gjuha është proces në zhvillim e sipër, por njerëzit kanë ndjenjë se ekziston një e drejtë dhe një e gabuar. Problemi është se jo të gjithë bien dakord se si duhet të jetë ajo gjuhë. Traditat po lëvizin aq shpejt sa që është e vështirë për këdo që rrijë anash”, shton Prewitt-Freilino. “Mund të përdoret gjithashtu si mekanizëm mbrojtës i ‘a je për a kundër?’ pa e njohur diskutimin pse njerëzit të ndryshëm vlerësojnë terma të ndryshëm rreth identitetit dhe se duhet të jetë gjithmonë një diskutim”.

Ka pasur një bashkëveprim të rëndësishëm midis bisedave rreth gjinisë dhe identitetit dhe mënyrës se si ato përfaqësohen në gjuhë. Për vite me radhë, komuniteti i Amerikës Latine në ShBA ka diskutuar terma të ndryshëm të identitetit – së pari duke iu kundërvënë ‘hispanikes’ e cila u pa si fjalë koloniale që promovon trashëgiminë spanjolle, pastaj duke përdorur “latino/a” si mënyrë për të bërë bashkë në mënyrë domethënëse grupet e ndryshme etnike, dhe tani po

punojnë për të reformuar termat gjinorë përmes etiketës ‘Latinx’. Por, megjithëse “Latinx” po përdoret nga disa të rinj në ShBA, shumë njerëz me origjinë latino-amerikane në vendet e tjera, nuk identifikohen me të.

“Edhe nëse nuk është miratuar plotësisht, tani është pjesë e diskutimeve”, thotë psikologu politik, Efrén O. Pérez. “Është zbatimëse kur e shpalos atë si shkencëtar social. Mund të flisni se si nuk ju pëlqen fjala apo jo, por, pasi ta përdorni, në të vërtetë ndikon në mënyrën se si mendoni për politikën”.

Njerëzit mund të heqin dorë nga gjuha neutrale gjinore, duke e parë atë si të panevojshme ose thjesht ideologjike, por hulumtimi i Pérezit tregon se në të vërtetë ndikon në opinionin publik. Studimi i tij i vitit 2019, me Margit Tavitsin, zbuloi se përdorimi i përemrave neutralë gjinorë shton qëndrimet pozitive ndaj grave dhe personave LGBTQ+, përmes zvogëlimit të rëndësisë së identitetit mashkullor dhe më pas duke shkaktuar më pak paragjykimet të bazuara në gjini.

“Gjuha jonë në fakt e drejton vëmendjen tonë te disa aspekte të realitetit dhe larg aspekteve tjera të realitetit. Nëse flas anglisht, kam më pak të ngjarë të bëj dallime mashkull/femër sesa nëse flas spanjisht”, shpjegon Pérez. “Nuk mund ta ndryshoni kulturën, por siç zbulojnë disa nga këta terma neutrale gjinorë, mund të përshtatni termat që përdorni. Ndoshta nuk mund të ndryshojmë fjalorë të tërë, por pasi të keni futur disa opsione të paanshme gjinore në masën që njerëzit t’i zbatojnë apo pajtohen në to, kjo ka rëndësi”.

Njerëzit gjithashtu kanë gjetur mënyra për të krijuar mundësi neutrale gjinore brenda

strukturave ekzistuese gjuhësore. Shweta Vaidya, shkrimtare transgjinore me qendër në Mumbai, përdor formën shumëse “hum” (ne) të hindishtes si një alternativë asnjëse gjinore.

“Shmang gjininë time duke përdorur një zë pasiv, dhe nëse dua të pohoj përemrat e mi femërorë, e bëj, por nganjëherë është më e lehtë të jesh asnjëse në aspektin gjinor”, thotë Vaidya. “Kur përdor ‘hum’, nuk kam pse të përdor mbaresa gjinore dhe nuk është e çuditshme në hindisht, sepse njerëzit flasin kështu në vendet si Kanpur, Chhattisgarh dhe Madhya Pradesh në Indinë Qendrore”.

Identiteti dhe shprehjet gjinore janë unike në çdo kulturë, por gjuha përreth është ende e kufizuar.

Përkufizimet perëndimore të dallimeve gjinore kanë tendencë të lënë në hije mënyrën se si ne e shohim identitetin gjinor, madje edhe në pjesë të tjera të botës. “Të jesh transeksual në fjalorin perëndimor, ky është sistemi që po ndjekim tani, i cili ka disa kufizime në atë që njerëzit e perceptojnë si normë. Gjinia është kolonizuar – pakicat gjinore si komuniteti Fa afafine në Samoa, janë përfaqësuar si burra homoseksualë, kur ata kanë kuptimin e tyre të identitetit gjinor”, shton Vaidya. “E dimë që ka pasur një përshtatje të gjuhës, ku nuancat kulturore rreth gjinisë kanë humbur në përkthim, por ne nuk i kemi korrigjuar gabimet tona. Përkthimi nuk është i lehtë, veçanërisht kur përpikësh të përkthesh përvojat kulturore në identitete”.

Por, edhe nëse kulturat kanë gjuhë për dallimet gjinore, kjo nuk garanton mirëkuptim ose praninë. “Hijras” – grup

sociokulturor i grave transgjinore dhe njerëzve interseksualë të përshkruar si “gjinia e tretë” – kanë një histori të gjatë në kulturën e Azisë Jugore. Por, për shekuj me radhë, “hijra”-t dhe “transgjinorët” janë përdorur në vend të njëjtë, gjë që ka çuar në keqkuptimin dhe nënvlerësimin e komunitetit transgjinor të Indisë. Kur Bill i Personave Transgjinorë u miratua vitin e kaluar, përkthimi në Hindisht përdori termin ubhaylingi (hermafrodit) për të përfaqësuar njerëzit trans, kështu që ligji nuk mbron ose njeh të gjithë komunitetin. “Ashtu si shumë njerëz trans kanë pyetur në mënyrë të përsëritur, ‘Nëse supozohet të jemi gjinia e tretë, kush do të jetë i pari?’” Shpjegon Vaidya. Në këtë mënyrë, gjuha ka një ndikim të pamohueshëm se kush mund të ketë të drejta të barabarta.

Reforma në gjuhë është e mundur, por kërkon kohë. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht çmontim i sistemeve ekzistuese, por të lësh hapësirë për opsione më përfshirëse. Në vend që të lejojmë gjuhën të ndërtojë mënyrën se si e shohim botën, mund të shkojmë në drejtimin tjetër, duke hulumtuar se si mund ta pasqyrojmë botën përmes zgjedhjes sonë të gjuhës. “Është e vështirë të mendosh për sistemet e gjuhës, pa menduar për kontekstin më të globalizuar në të cilin jemi duke ekzistuar”, thotë Prewitt-Freilino. “Mendoj se është merr e jep – se cilët terma krijojnë; si gjuha zhvendoset dhe si përdoret në mënyra të ndryshme. Ajo që është me të vërtetë interesante, për mua, është se çka marrin gjuha dhe kultura nga njëra-tjetra”. /Përktheu: Telegrafi.com/



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

'Dardanët' nuk thyhen në Greqi

Kosova ka marrë një barazim në Athinë sonte kundër Greqisë për të filluar këndelljen pas disa humbjeve rresht. Madje Greqia ka pasur fat në pjesën e dytë sepse disa mundësi të Kastratit dhe Paqaradës Kosova do të mund të ishte kthyer në Prishtinë me pikë të plota

Kosova ka bërë një njërën prej ndeshjeve më të mira në këtë muaj në Athinë sonte. Aro Muric ishte kryefjala e pjesës së parë derisa në pjesën e dytë Lirim Kastrati dhe Paqarada ishte shumë afër për të kaluar Kosovën në epërsi. Kosova ka marrë një pikë të madhe në Athinë sonte kundër Greqisë duke barazuar me rezultat 0-0.

Edhe këtë takim Kosova e nisi shumë më mirë sesa Greqia, madje ishte shumë afër për të shënuar por që pas minutës së 10-të Greqia fillon ta marrë avantazhin.

Nga presioni, Herolind Shala do të shkaktonte penallti në minutën e 18-të dhe kjo do të ishte një goditje për Kosovën. Por, shpëtimtar i Kosovës do të ishte Aro Muric, i cili priti penalltinë e Bakasetas. Muric do të tregojë vendimtar edhe me tri pritje të tjera gjatë pjesës së parë.

Në pjesën e dytë ishte Kosova që dominoi takimin. Fillimisht Lirim Kastrati u gjend para golit në minutën e 46-të por priti portieri grek. Rastin me ideal e pati Paqarada në minutën e 53-të ku goditjen e tij nga vija e portës e hoqi një mbrojtës grek.

Pas minutës 60-të, Greqia bëri disa ndryshime në mesfushë dhe filloi ta këtë posedimin por që nuk ishte shumë i rrezikshëm për Kosovën.

Pas këtij barazimi Kosova ka 2 pikë dhe mban vendin e tretë derisa Sllovenia pas fitores se sotme kundër Moldavisë 0-4 është në vendin e parë me 10 pikë.

Greqia mbetet në vendin e dytë me 8 pikë në grupin 3 të Ligës C të Kombeve.



Kastrati: Nuk kisha vetëbesim, duhet të luajë më shumë me Kombëtaren

Sulmuesi i Kosovës, Lirim Kastrati pati një njërën prej paraqitjeve të tija më të mira me Kosovën, derisa ka thënë se nëse do të kishte minuta më tepër ndoshta sot do të kishte shënuar gol.

Megjithatë, në një ndeshje si kjo kundër Greqisë, Kastrati ka



thënë se nuk është i kënaqur me barazimin por është i kënaqur me paraqitjen.

"Si unë dhe çdo lojtarë kemi dëshirë që t'i ndihmojmë skuadrës. Kemi pasur një

ndeshje të vështirë kundër Greqisë, sot kemi pasur më shumë shanse por nuk mundëm që t'i shfrytëzonin", ka thënë Kastrati.

Sulmuesi i Dinamo Zagrebit ka thënë se i ka munguar vetëbesimi për mos t'i shfrytëzuar këto raste por ai ka thënë se i ka munguar vetëbesimi si dhe paraqitjet e pakta me Kosovën që të shënoi gol.

"Nuk kam luajtur shumë me Kosovën, dhe nuk kam pasur vetëbesim. Nëse do të kisha përvojë do të shënoja", ka thënë ai.

Megjithatë në fund Lirimi ka thënë se ishte një rezultat i mirë pas disa rezultatëve të dobëta që pati Kosova në ndeshjet e fundit.

Challandes: Ishte një ndeshje e bukur kolektive

Trajneri i Kosovës, Bernard Challandes ka thënë se është i kënaqur me paraqitjen e Kosovës kundër Greqisë, derisa ka thënë se kanë arritur që ta lokalizojnë kundërshtarin "sidomos krahët e rrezikshme të tij".

"Kemi pasur disa probleme në pjesën e parë, veçanërisht në krah sepse kemi të bëjmë me një kundërshtar të fortë në krah. E përmirësuan këtë në pjesën e dytë duke i mbyllur krahët e kundërshtarët", ka thënë ai.

Challandes është i kënaqur me paraqitjen e saj.

"Problemi nuk është



mbështetja. Unë jam i kënaqur sepse skuadra nuk u dorëzua. Unë jam një trajner që synoj që të luajë ofensivë. Sot ishte e rëndësishme që të mbrohemi sidomos tani kur nuk kemi një moment të mirë".

Trajneri i Kosovës ka thënë se është e rëndësishme që kjo

skuadër të luajë bashkë.

Duke folur për penalltinë, Challandes ka thënë se nuk është i "kënaqur".

"Nuk isha i kënaqur me vendimin e gjyqtarit. Është shumë e rëndësishme për një portier të mbrojë një penallti dhe kjo i jep mentalitet skuadrës për të luftuar bashkë", ka thënë ai.

Challandes ka folur edhe për Lirim Kastratin për të cilin tha se ka bërë një paraqitje të mirë.

"Mendoj që Lirim Kastrati ka luajtur një ndeshje të mirë dhe do ta shfrytëzojmë atë në të ardhmen", tha trajneri i Kosovës.

Drita e mposht Trepçën '89, e vazhdon ecurinë e përkryer

Drita e ka mundur 1:0 Trepçën '89, në një ndeshje të mbetur të Superligës, duke e vazhduar ecurinë e përkryer të fitoreve në përpjekje për ta mbrojtur titullin.

Betim Haxhimusa e shënoi atë që ishte goli i tri pikëve të radhës për Dritën në Stadiumin e Qytetit në Gjilan të mërkurën.

Kjo ishte një ndeshje e mbetur nga java e dytë, kur Drita ishte e zënë në kualifikime për Ligën e Evropës.

Haxhimusa, i futur në lojë nga stoli, shënoi me kokë pas një pasimi nga Kastriot Rexha në minutën e 58-të.

Kampionia në fuqi e mbizotëroi

plotësisht skuadrën mitrovicase, por dështoi t'i shfrytëzojë rastet e shumta.

Bardhekaltrit e qëlluan shtyllën dy herë, në pjesën e parë me Vucaj dhe pastaj në minutën e 66, kur Kastriot Rexha e qëlloi atë pas një goditjeje me kokë.

Rasti më i mirë për skuadrën e Trepçës'89 ishte në minutën e 52, Muja e kaloi pothuajse të gjithë skuadrën e Dritës dhe ia pasoi topin Bismarck, por Maloku ishte në vend dhe priti goditjen e tij.

Haxhimusa ka mundur ta dyfishonte epërsinë e Dritës me golin e dytë personal në këtë takim tre minuta para fundit kur

u gjend përballë portierit, por goditja e tij shkoi lart mbi portë. Kampioni në fuqi në tri xhiro të zhvilluara ka gjithsej nëntë pikë dhe ngrihet në pozitën e dytë me dy ndeshje më pak të zhvilluara. Ndërsa mitrovicasit janë në pozitën e pestë me gjithsej gjashtë pikë të grumbulluara ku kanë vetëm dy fitore dhe tri humbje në pesë ndeshjet e zhvilluara.

Ndërsa të dielën do të zhvillohet derbi lokal Drita – Gjilani, ndeshja do të luhet në ora 13:30 në Stadiumin e Qytetit në Gjilan, pa praninë e tifozëve në stadium.

Në tri ndeshjet e fundit të



zhvilluara në mes Dritës dhe Gjilanit, dy ndeshje të fituara nga skuadra e dritës ndërsa

ndeshja e fundit është fituar nga skuadra e Gjilanit me rezultat 2:0.



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova/ Republika of Kosovo
Komuna Dragash/Opština Dragas/ Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM DRAGASH

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, nr. 04/L-032, neni 2 paragrafi 4.1 Udhëzimit Administrativ Nr 34/2014 Funksionimi i shërbimit pedagogjik –psikologjik në shkollë, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Udhëzimit Administrativ Nr 26/2013 Zgjedhja e nëpunësve për ofrimin e shërbimeve profesionale në institucione edukative – arsimore parauniversitare.Dhe mbrojtjes së tepçicave të mundshme teknologjike në shkollë. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

13/651

14.10.2020

KONKURS TË BRENDSHËM

Për vendin e lirë të punës në shkollat " 28 Nëntori" në Brodosanë, " Samidin Emiri"-Kuk dhe "Ulina" në Kosovë

Një (1) pedagog/e shkolle

PUNËT DHE DETYRAT E PEDAGOGUT/ES

- Mban lidhje me ekipin profesional të shkollës.
- Mbështet mësimdhënësit në realizimin e planprogramit.
- Merr pjesë në hartimin e PIA.
- Bashkëpunon me stafin dhe mësimdhënësit.
- Merr pjesë në takimet me prindër.
- Merr pjesë në vlerësimin nxënësve në QB.
- Kontrollon dhe vlerëson planprogramet e hartuar nga mësimdhënësit.
- Këshillon dhe ndihmon mësimdhënësit në situata te ndryshme.
- Mban dosje për sjelljet edukative të nxënësve.
- Mban dosje pedagogjike për mësimdhënësit.
- Këshillon mësimdhënësit në hartimin e planeve të përshtatshme për nxënës.
- I raporton drejtorit për vëzhgimet, monitorimet, mentorimet pedagogjike me mësimdhënësit.
- Bashkëpunon me mësuesit udhëtues.
- Merr pjesë në takimet me ekipin bërthamë të Qendrave Burimore.
- Merr pjesë në monitorime të planifikuara të shkollës së bashku me drejtorin.
- Kryen detyra tjera të caktuara nga drejtori.

KUALIFIKIMI PËR PEDAGOG/E

- Fakulteti Filozofik – Dega e Pedagogjisë Master, përkatësisht Fakulteti i Edukimit studime katërvjeçare në Degën e Pedagogjisë
- Fakulteti i Filozofik – Dega e Pedagogjisë.

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk iu kthehet kandidatëve.

Datë: 14.10.2020
 Dragash

Drejtori i DKA-së
 MSc. Vloran Cenaj

v.v.



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opština Dragas/ Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



